



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 1 nëntor 2019
Nr. ref.: RK1463/19

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI 201/18

Parashtrues

Selami Taraku

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme
Rev. nr. 322/2018 të 15 tetorit 2018**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Selami Taraku nga Prishtina (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), të cilin e përfaqëson përfaqësuesi i autorizuar Naim Krasniqi nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 322/2018, të 15 tetorit 2018.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se janë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 46 [Mbrotjtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), dhe me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt); nenin 1 të Protokollit nr. 1 (Mbrotjtja e Pronës), të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ) si dhe me nenin 10 të Deklaratës Universale për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejme: DUDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenin 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 21 dhjetor 2018, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 8 janar 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu Krasniqi (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Radomir Laban (anëtar).
7. Më 1 shkurt 2019, parashtruesi i kërkesës dorëzoi dokumente shtesë në Gjykatë.
8. Më 27 mars 2019, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi Gjykatës Supreme një kopje të kërkesës.
9. Më 8 tetor 2019, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 19 maj 2016, me vendimin nr. 1/73 të Rektoratit të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" (në tekstin e mëtejme: Rektorati), parashtruesit të kërkesës i ishte ndërprerë marrëdhënia e punës në pozitën e ligjëruesit në Fakultetin e Arteve, për shkak të arritjes së moshës së daljes në pension.

11. Më 11 nëntor 2016, parashtruesi i kërkesës parashtroi padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, kundër Rektoratit, në të cilën kërkoi që Rektorati të detyrohet të ia paguajë tri paga pas daljes në pension dhe tri paga si shpërblim jubilar.
12. Më 29 maj 2017, Gjykata Themelore në Prishtinë [Aktgjykimi C. nr. 2797/16] e miratoi padinë e parashtruesit të kërkesës dhe e detyroi Universitetin e Prishtinës *“që paditësit në emër të shpërblimit për tre paga përcjellëse për pension dhe tre pagave për shpërblim jubilar, t’i paguaj shumën prej 6,160.2 euro, si dhe shpenzimet e procedurës prej 404 euro, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% dhe atë duke filluar prej datës 14.11.2016 [...]”*. Në arsyetimin e Gjykatës Themelore, ndër të tjera, thuhet: *“Me Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive të Kosovës, të miratuara nga Qeveria e Kosovës dhe Oda Ekonomike e Kosovës –dispozitat e së cilës aplikohen në tërë territorin e Kosovës, me nenin 52 është paraparë e drejta e punëtorit në pagesën për përcjellje në pension dhe nenin 53 është parapare e drejta në shpërblim jubilar pas pensionimit. Gjykata vlerëson se kjo e drejtë i takon paditësit në kuptim të dispozitave të lart cituara, për çka edhe vendosi që kërkesëpadinë e tij ta miratoj të bazuar”*.
13. Në një datë të pacaktuar, Rektorati parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, për shkak të *“aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa, ashtu që aktgjykimi i goditur të ndryshohet dhe të refuzohet kërkesëpadia e paditësit”*.
14. Më 14 maj 2018, Gjykata e Apelit [Aktgjykimi Ac. nr. 4531/2017] refuzoi si të pabazuar ankesën e Rektoratit dhe vërtetoi në tërësi aktgjykimin e Gjykatës Themelore. Në arsyetim, Gjykata e Apelit theksoi: *“Thëniet ankimore lidhur me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale janë të pabazuara. Kjo për faktin se me marrëveshjen e përgjithshme kolektive të Kosovës ne nenin 52, është paraparë se i punësuar ka të drejtë në shpërblim jubilar, e nga ana tjetër neni 53 i marrëveshjes së përgjithshme kolektive të Kosovës parasheh se i punësuar me rastin e pensionimit gëzon të drejtën në pagesën përcjellëse në rast të pensionimit në lartësi prej 3 pagave mujore. Prandaj, edhe kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale kur ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit[...].”*
15. Në një datë të pacaktuar, Rektorati parashtroi kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, *“për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që dy aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët të ndryshohen dhe të refuzohet kërkesëpadia e paditësit apo të prishen dhe lënda të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë”*.
16. Më 10 tetor 2018, Gjykata Supreme, me Aktgjykimin Rev. nr. 322/2018 e pranoi revizionin e Rektoratit dhe ndryshoi aktgjykimet e Gjykatës Themelore dhe të Gjykatës së Apelit, ashtu që e refuzoi si të pabazuar padinë parashtruesit të kërkesës që ta detyrojë Rektoratin që t’i paguajë parashtruesit të kërkesës në emër të shpërblimit tri paga përcjellëse për dalje në pension dhe shpërblimin jubilar. Në këtë Aktgjykim, ndër të tjera, theksohet se:

“Çështja e pagesave përcjellëse për pension dhe për shpërblimin jubilar me rastin e pensionimit të stafit akademik me titull profesor i rregullt nuk është e rregulluar me Ligjin Nr. 04-037 për Arsimin e Lartë të Republikës së Kosovës, e as me Statutin e Universitetit “Hasan Prishtina” në Prishtinë, ku është specifikuar statuti i çdo bartësi të arsimit të lartë.

Të dy gjykatat gabimisht e kanë zbatuar të drejtën materiale kur me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësit janë bazuar në dispozitat e lartpërmendura të Kontratës së Përgjithshme kolektive, kjo nga se rektoret dhe dekanatet nuk e kanë lidhur aneks kontratën me sindikatat përkatëse të universitetit dhe fakultetit për pagesat e këtyre pagave për stafin akademik me titull profesor. Prandaj, për pagesën e këtyre pagave paditësit nuk mundë ti referohemi Kontratës së Përgjithshme Kolektive për arsye se për punëtorët këto kontrata i ka nënshkruar bashkësia e Sindikatave të pavarura të Kosovës (BSPK), Qeveria e Kosovës - Kryeministri i Republikës së Kosovës, përpunëdhënësin Oda Ekonomike e Kosovës, Këshilli Ekonomik Social-Kryesuesi i saj dhe për Aleancën Kosovare të Biznesit -Kryetari i saj. Si që shihet, për stafin akademik me titull profesor këtë kontratë nuk e kanë nënshkruar rektorët dhe dekanatet me sindikatat përkatëse”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

17. Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta i kanë shkelur të drejtat e mbrojtura me nenet 31 dhe 46 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1. të KEDNJ-së dhe të drejtat e garantuara me nenin 10 të DUDNJ-së, pasi që pas daljes në pension nuk i është mundësuar pagesa e shpërblimit jubilar dhe përfitimet tjera që vijnë me shpërblimin jubilar.
18. Parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimi i kontestuar nuk është në përputhje me praktikën e mëparshme gjyqësore të Gjykatës Supreme, duke cituar vendimin konkret në të cilin, sipas tij, Gjykata Supreme ka vendosur ndryshe.
19. Parashtruesi i kërkesës e arsyeton shkeljenë nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, duke theksuar se “Gjykata Supreme e Kosovës ka interpretuar gabimisht jo saktë të drejtën materiale, nuk ju ka referuar si duhet Ligjit të Punës, Marrëveshjes së përgjithshme Kolektive dhe fare nuk ju ka referuar Kontratës Kolektive të nënshkruar nga Ministri i Arsimit [R.B] dhe SBASHK-u me datë 11.04.2014.”.
20. Sipas parashtruesit të kërkesës, “Gjykata Supreme e Kosovës dhe vet gjyqtarja e çështjes, për Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive KA DY OPINIONE KUNDËRTHËNËSE [...] Në lëndën REV. nr. 98/2017 Gjykata Supreme e Kosovës thotë se REVIZIONI REFUZOHET duke pranuar qëndrimin [...] se Marrëveshja Kolektive është e zbatueshme edhe në këtë rast Dega e Sindikatës konkrete nuk kishte kontratë me punëdhënësin Konkret”.

21. Më tutje, pasi thekson se Gjykata Supreme nuk bënë dallim në mes të dispozitave imperative dhe fakultative të Ligjit të Punës dhe të Marrëveshjes Kolektive, parashtruesi i referohet nenit 4 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive, i cili përcakton se: "Dispozitat e MPKK i obligojnë punëdhënësit të cilët, në çfarëdo mënyre, kryejnë veprimtari ekonomike, joekonomike dhe shërbime civile. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet edhe në nivel të degës edhe në nivel të Ndërmarrjes". Në ndërlidhje me këtë, parashtruesi potencon se Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive "është obligative, kurse degët e sindikatave mund të lidhin kontratë kolektive por kjo është fakultative".
22. Parashtruesi poashtu shprehet se *"Nuk qëndron ajo se në emër të UP-nuk është lidhur kontratë kolektive dhe kjo dëshmohet me Kontratën Kolektive të lidhur nga Ministri [R.B.] me datë 11.04.2014 dhe SBASHK-ut [...] Gjykata Supreme anashkalon Kontratën Kolektive që përfshinë stafin Universitar por aq më tepër kjo kontratë i jep fuqi Marrëveshjes Kolektive në nenin 2 e cila thotë se për çështje që nuk janë përfshi të Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë zbatohet Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive"*.
23. Parashtruesi i ankesës, më tej, pretendon shkelje të nenit 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së, duke theksuar: *"Gjykata Supreme shkel të drejtën e paraqitësit të kërkesës për të drejtat e tij në Pagat Pensionale sipas aktgjykimeve të shkallës së parë dhe të dytë[...], pritshmëria legjitime e parashtruesit mbështetet në të drejtën e tij në kompensimin si rezultat i vendimeve të plotfuqishme dhe të drejtën e tij për pagat pensionale [...] dështimi për t'i njohur parashtruesit të drejtën sipas Aktgjykimeve të plotfuqishme që janë refuzuar me aktgjykimin e Gjykatës Supreme përbën cenim të drejtpërdrejt të së drejtës së pronësisë"*.
24. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që ta pranojë kërkesën si të pranueshme dhe ta shpallë të pavlefshëm dhe ta kthejë në rigjykim Aktgjykimin Rev. nr. 322/18, të Gjykatës Supreme, të 10 tetorit 2018.

Dispozitat relevante ligjore

Ligji nr. 03/L-212 i Punës (i 1 nëntorit 2010)

Neni 90 **Marrëveshja Kolektive**

1. *Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet:*
 - 1.1. *organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe*
 - 1.2. *organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve;*
2. *Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në:*

- 2.1. nivel të vendit;
 - 2.2. nivel të degës;
 - 2.3. nivel të ndërmarrjes.
3. Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës.
 4. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet;
 5. Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive;
 6. Marrëveshja Kolektive nuk mund të përfshijë dispozita të tilla që kufizojnë të drejtat e të punësuarve që kanë si pasojë kushte më pak të favorshme të punës sesa ato të përcaktuar në këtë ligj.
 7. Punëdhënësi ua vë në dispozicion të punësuarve një kopje të Marrëveshjes Kolektive.
 8. Marrëveshja Kolektive regjistrohet në Ministri, në pajtim me kushtet dhe kriteret e paracaktuar me aktin nënligjor.
 9. Për zgjidhjen e kontesteve të ndryshme në mënyrë paqësore dhe zhvillimin e konsultave nga fusha e punësimit, mirëqenies sociale dhe politikave ekonomike të punës nga përfaqësuesit punëdhënësve, punëmarrësve dhe Qeverisë në cilësi të partnerëve social me akt te veçantë ligjor-nënligjor themelohet Këshilli Ekonomiko Social.
 10. Çështjet e tjera të dialogut social rregullohen me akt ligjor ose nënligjor, varësisht nga marrëveshja e arritur nga partnerët social.

Ligji nr. 04/L-037
për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës
(i 29 gushtit 2011)

Neni 28
Kushtet e shërbimit të personelit

1. Statuti i një institucioni publik të arsimit të lartë përmban dispozita lidhur me emërimet, mandatet, ngritjen në pozitë, disiplinën, suspendimin, shkarkimin, pushimin nga puna apo pensionimin.
2. Kushtet themelore të shërbimit të personelit në bartësit e arsimit të lartë duhet të jenë në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Kushte të tjera të shërbimit të personelit te bartësit publik të arsimit të lartë, përcaktohen nga këshilli drejtues i bartësit, i cili krijon kuadrin e

përshtatshëm për konsultime me sindikatat e njohura zyrtarisht me përfaqësuesit e personelit dhe me Ministrinë.

4. Çdo anëtar i personelit punësohet mbi bazën e kontratës individuale me bartësin e arsimit të lartë. Kontratat e tilla do të përfshijnë aranzhimet për vlerësim të rregullt të performancës së stafit duke përfshirë vëzhgimin e drejtpërdrejtë të mësimit dhe një proces të strukturuar për mbështetjen e zhvillimit profesional të tij.

5. Statuti i një bartësi publik të arsimit të lartë rregullon pjesëmarrjen e ekspertëve ndërkombëtar në komisione recenzuese në procesin e përzgjedhjes së personelit akademik me status të profesorit.

6. Statuti i bartësit të arsimit të lartë përfshin dispozita, të cilat përcaktojnë rrethanat, mbi bazën e të cilave një anëtar i personelit mund të punësohet në një punë të dytë me ose pa pagesë dhe që kufizojnë përgjegjësinë ligjore të punëdhënësit në raste të tilla.

Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës
(e nënshkruar me 18.03.2014 dhe hyrë në fuqi me 01.01.2015)

Në mbështetje të nenit 90, të Ligjit të Punës, dispozitat e Ligjit për Këshillin Ekonomiko-Social dhe Ligjit mbi organizimin sindikal në Kosovë, Organizatat e Punëdhënësve (Oda Ekonomike e Kosovës dhe Aleanca Kosovare e Biznesit), Organizatat e të Punësuarve (Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës) si dhe Qeveria e Republikës së Kosovës (Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale), lidhin:

Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës

Neni 2
[Fushëveprimi]

1. Dispozitat e MPKK, obligojnë palët në Marrëveshje në sektorin privat, publik dhe shtetëror (në nivel të përgjithshëm, në nivel të degëve dhe në nivel ndërmarrjeje).

2. Dispozitat e MPKK vlejnë për nxënësit, studentët në aftësim profesional.

3. Dispozitat e MPKK vlejnë edhe për të punëdhënësit dhe të punësuarit me shtetësi të huaj, ose pa shtetësi të cilët ushtrojnë veprimtari ekonomike në Republikën e Kosovës.

4. Dispozitat e MPKK nuk vlejnë për punëdhënësit, ose përfaqësuesit e tyre dhe të punësuarit ose përfaqësuesit e tyre, të përcaktuar me nenin 2, paragrafin 4, të Ligjit të Punës në Kosovë.

Neni 3
[Aplikimi dhe përfshirja]

Dispozitat e MPKK aplikohen në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Neni 4

- 1. Dispozitat e MPKK i obligojnë punëdhënësit të cilët, në çfarëdo mënyre, kryejnë veprimtari ekonomike, joekonomike dhe shërbime civile. Marrëveshja Kolektive, mund të lidhet edhe në nivel të Degës dhe të Ndërmarrjes.*
- 2. Degët e sindikatave të veprimtarive joekonomike (shërbimet civile, publike dhe ndërmarrjet publike), lidhin kontratë të posaçme me punëdhënësit e tyre (ministritë përkatëse, atë të Administratës Publike, Arsimit, Shëndetësisë, etj), në pajtim me specifikat e tyre.*

Neni 5

MPKK, vlen për të gjithë të punësuarit të cilët punojnë tek punëdhënësit, që kanë selinë në territorin e Kosovës.

Neni 52

Shpërblime jubilarë

- 1. I punësuar, ka të drejtë në shpërblimin jubilar dhe atë:*
 - 1.1. për 10 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të një paga mujore të tij;*
 - 1.2. për 20 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të dy paga mujore të tij;*
 - 1.3. për 30 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të tri paga mujore të tij.*
- 2. Punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblime jubilarë.*
- 3. Shpërblimi jubilar, paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf.*

Neni 53

Kompensimi në rast të pensionimit

I punësuar, me rastin e pensionimit, gëzon të drejtën në pagesën përcjellëse në lartësi prej tri (3) paga mujore, që i ka marr për tre (3) muajt të fundit.

Kontrata Kolektive e Arsimit Parauniversitar
(e nënshkruar me 11.04.2014)

Neni 1
Qëllimi

- 1. Qëllimi i Kontratës kolektive për arsimin parauniversitar është përcaktimi dhe rregullimi më i qartë dhe më i detajuar i të drejtave, përgjegjësi dhe detyrimeve të palëve në këtë kontratë.*
- 2. Në këtë kontratë mund të mbështeten dhe të përfitojnë edhe të punësuarit në arsimin e lartë dhe në kulturë, kur hartojnë kontratat e nivelit të dytë, për ato dispozita që përbëjnë standard të përgjithshëm në marrëdhëniet midis punëdhënësit dhe punëmarrësit, të përcaktuara në konventat ndërkombëtare të punës dhe në Ligjin e Punës të Republikës së Kosovës.*
- 3. Për mësimdhënësit universitarë e shkencorë dhe për personelin ndihmës në arsimin e lartë dhe në kulturë, aneks kontratat lidhen në mes të rektorateve e dekanateve, nga njëra anë, dhe sindikatave përkatëse të çdo universiteti dhe fakulteti, nga ana tjetër.*
- 4. Për organizatat sindikale komunale dhe DKA-të mund të lidhen kontrata të nivelit të dytë.*

Neni 2
Zbatimi i kontratës

- 1. Për të drejtat dhe obligimet që nuk janë përfshirë në këtë kontratë, zbatohet legjislacioni në fuqi dhe kontrata kolektive e përgjithshme.*

1.1. Dispozitat e kësaj kontrate kolektive, janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të arsimit parauniversitar (parashkollor, fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë) në mbarë territorin e Republikës së Kosovës të cilët janë anëtar të SBASHK-ut.

Neni 36
Garantimi i pagës

[...]

- 9. Punëtorët (anëtarë të SBASHK-ut) që dalin në pension përfitojnë shpërblimin jubilar [...].*
- 10. Punëtorët (anëtarë të SBASHK-ut) që dalin në pension përfitojnë pagesë përcjellëse në lartësi të tri (3) pagave sipas mesatares së tri pagave të fundit të punëtorit.*

Neni 51
Dispozitat kalimtare

1. Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive që kanë implikime financiare fillojnë të zbatohen nga data 01.01.2015, ndërsa dispozitat tjera fillojnë të zbatohen menjëherë.

Neni 52
Dispozitat shfuqizuese

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj kontrate shfuqizohet Kontrata kolektive për të punësuarit në arsimin fillor dhe të mesëm të Kosovës.

Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë
(e nënshkruar me 18.04.2017)

Neni 2
Zbatimi i kontratës

1. Për të drejtat dhe obligimet që nuk janë përfshirë në këtë Kontratë, zbatohet legjislacioni në fuqi dhe Kontrata kolektive e përgjithshme.

1.1. Dispozitat e kësaj Kontrate kolektive, janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të Arsimit Parauniversitar (parashkollor, fillor, të mesëm të ulët, dhe të mesëm të lartë, shkolla speciale e qendra të kompetencës) dhe institucionet e arsimit të lartë në tërë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtar të SBASHK-ut.

1.2. Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat-DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës.

Neni 35

8. Punëtorët (anëtarë të SBASHK-ut) në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit [...].

9. Punëtorët (anëtarë të SBASHK-ut) që dalin në pension përfitojnë pagesë përcjellëse në lartësi të tri pagave sipas mesatares së tri pagave të fundit të punëtorit.

Neni 48
Dispozita shfuqizuese

Me hyrjen në fuqi të kësaj kontrate shfuqizohet Kontrata Kolektive e Arsimit Parauniversitar në mes të MASHT dhe SBASHK Nr. 01B-2200, datë 11.04.2014.

Neni 49
Hyrja në fuqi

Kjo kontratë Kolektive, hyn në fuqi ditë e nënshkrimit të saj nga palët nënshkruese të kontratës.

Pranueshmëria e kërkesës

25. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të qartësuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.
26. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:
- 1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.
[...]*
- 7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.*
27. Në vazhdim, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa Individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47 i Ligjit
[Kërkesa individuale]

1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.
2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të këtë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj:

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
[Afati]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]”.

28. Sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata konstaton se parashtruesi është palë e autorizuar, e cila konteston aktet e një autoriteti publik, pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka sqaruar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se i janë shkelur, përmes vendimeve të gjykatave të rregullta, në pajtim me kushtet që kërkojnë nga neni 48 i Ligjit, si dhe ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.
29. Megjithatë, Gjykata duhet të vlerësojë më tej nëse janë plotësuar kriteret e parapara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, ku përcaktohet se:

(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështet në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.

30. Gjykata së pari vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të të drejtave të garantuara me nenet 31 dhe 46 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1.1 të KEDNJ-së dhe nenin 10 të DUDNJ-së. Sipas parashtruesit të kërkesës, këto të drejta i janë shkelur sepse gjykatat e rregullta:

a) kanë interpretuar gabimisht ligjin, përkatësisht të drejtën materiale duke mos ju referuar si duhet Ligjit të Punës, Marrëveshjes së përgjithshme Kolektive dhe duke anashkaluar Kontratën Kolektive të nënshkruar nga Ministri i Arsimit dhe SBASHK-u me datë 11.04.2014;

b) kanë qenë jo-konsistente, duke zbatuar praktikë të ndryshme gjyqësore nga ajo që e kanë zbatuar në raste të ngjashme. Në këtë mënyrë, sipas parashtruesit të kërkesës, Gjykata Supreme atij i ka shkelur garancinë kushtetuese të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe me këtë edhe të drejtën e pronës.

a) Lidhur me pretendimet e parashtruesit të kërkesës për interpretim të gabuar të ligjit, përkatësisht të ligjit material

31. Në dritën e kësaj, Gjykata vë në pah se pretendimet e parashtruesve të kërkesës, në thelb, kanë të bëjnë me interpretimin nga Gjykata Supreme të dispozitave përkatëse të së drejtës materiale (përkatësisht të Ligjit të Punës dhe Marrëveshjes së përgjithshme Kolektive dhe anashkalimin Kontratën Kolektive të nënshkruar nga Ministri i Arsimit dhe SBASHK-u).

32. Gjykata përsërit qëndrimin e saj të përgjithshëm se vërtetimi i drejtë dhe i plotë i gjendjes faktike, sikundër edhe interpretimet përkatëse ligjore, parimisht, hyjnë brenda juridiksionit të gjykatave të rregullta. Roli i Gjykatës Kushtetuese është që të sigurojë respektimin e standardeve dhe të drejtave të garantuara me Kushtetutë. Rrjedhimisht, Gjykata Kushtetuese nuk mund të veprojë si gjykatë e “shkallës së katërt” (Shih, në lidhje me doktrinën e “shkallës së katërt”, rastet e Gjykatës Kushtetuese KI86/11, parashtrues i kërkesës *Milaim Berisha*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 prillit 2012 paragrafi 33; si dhe rastet e bashkuara KI73/17, KI78/17 dhe KI85/17, parashtrues të

kërkesës *Istref Rexhepi dhe 28 të tjerë*, Aktvendim për papranueshmëri, i 27 nëntorit 2017, paragrafët 46 dhe 47).

33. Në lidhje me këtë, Gjykata thekson se interpretimi i te drejtës materiale dhe procedurale është detyrë parësore dhe brenda juridiksionit të gjykatave të rregullta (çështje e ligjshmërisë). Roli i Gjykatës Kushtetuese është vetëm të përcaktojë nëse efektet e interpretimit të tillë janë në pajtim me normat dhe standardet kushtetuese.
34. Në rastin konkret, Gjykata vëren se Gjykata Supreme ka dhënë arsye të qarta dhe të mjaftueshme për gjetjet dhe konstatimet e saj. Kështu, Gjykata Supreme sqaroi se dispozitat përkatëse të Kontratës së Përgjithshme Kolektive nuk mund tëzbatoheshin në rastin e parashtruesit, ngase rektorët dhe dekanatet nuk e kishin lidhur aneks-kontratën me sindikatat përkatëse të universitetit dhe fakultetit, për pagesat e pagave përcjellëse për pension dhe për shpërblim jubilar, për stafin akademik me titull profesor. Më tutje, Gjykata Supreme sqaroi se: *"[...] Profesori është staf akademik me titull të lartë i emëruar në bazë të procedurave të përcaktuara me Ligjin nr. 04 – 037 për arsim të lartë të Republikës së Kosovës dhe si i tillë ky titull nuk e ka pozitën e punëtorit e cila është rregulluar me Ligjin e Punës në Kosovë. Për këto arsye, si dhe për faktin se në nenin 90.1.5. të Ligjit të Punës në Kosovë, parashihet që Marrëveshja kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet kolektive nuk obligon edhe punëdhënësit dhe punëmarrësit të cilët nuk kanë marrë përsipërdetyrimet e përcaktuara me këtë marrëveshje, pasi që të njëjtën, si në rastin konkret, për staf akademik me titull të lartë profesor, as nuk e ka nënshkruar. Çështja e pagesave eventuale kontestuese do duhej eventualisht të parashihet me Ligjin nr. 04 – 037 Për Arsim të Lartë të Republikës së Kosovës, gjë e cila deri më tani nuk është bërë."*
35. Rrjedhimisht, Gjykata vëren se Gjykata Supreme ka konstatuar se, sipas rregullativës ligjore në fuqi, pretendimi i parashtruesit të kërkesës (përkitazi me pagesën e pagave përcjellëse për pension dhe shpërblim jubilar) nuk kishte mbështetje ligjore.
36. Gjykata vëren se parashtruesi shprehet se Gjykata Supreme nuk ka marrë parasysh Kontratën Kolektive të nënshkruar nga Ministri i Arsimit dhe SBASHK-u, më 11.04.2014. Por, Gjykata vlerëson se parashtruesi nuk ka argumentuar se kjo Kontratë Kolektive e Arsimit Parauniversitar (e vitit 2014) mbështet pretendimet dhe kërkesat e tij. Gjykata konsideron se, në dritën e dispozitave përkatëse të kësaj Kontrate Kolektive të Arsimit Parauniversitar, si dhe të akteve të tjera normative (të cituara më lartë), nuk mund të argumentohet se ka pasur interpretime arbitrare ligjore nga ana e Gjykatës Supreme.
37. Sa i përket pretendimeve të parashtruesit të kërkesës në lidhje me praktikën jokonsistente të Gjykatës Supreme, Gjykata vë në pah se parashtruesi i është referuar vendimit të Gjykatës Supreme në rastin REV. nr. 98/2017. Sipas tij, në këtë rast Gjykata Supreme ka marrë një qëndrim të ndryshëm nga rasti aktual, përkitazi me zbatimin e Kontratës së Përgjithshme Kolektive. Por, pas analizimit të vendimit në fjalë, Gjykata vëren se rrethanat dhe veçoritë e dy rasteve janë të ndryshme. Për më tepër, Gjykata vë në dukje se në rastin të cilit

i është referuar parashtruesi i kërkesës (përkatësisht rastit REV. nr. 98/2017), në vendimin për refuzimin e revizionit, Gjykata Supreme kishte arsyetuar se objekt i kërkesëpadisë nuk ishte vërtetimi i ekzistimit të marrëdhënies së punës në kohë të pacaktuar, por vlerësimi i ligjshmërisë së njoftimit për mospërtëritjen e kontratës së punës, i cili sipas Gjykatës Supreme, kishte qenë në kundërshtim me Ligjin e Punës.

b) Lidhur me pretendimin e parashtruesit të kërkesës për shkelje të së drejtës në pronë

38. Gjykata i referohet edhe pretendimeve të parashtruesit të kërkesës përkitazi me shkelje të të drejtës në pronë, të garantuar me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 [Mbrojtja e Pronës] të KEDNJ-së.
39. Gjykata rikujton se neni 46 i Kushtetutës dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 i KEDNJ-së, nuk garantojnë të drejtën për fitimin e pronës (Shih, *Vander Mussele kundër Belgjikës*, paragrafi 48, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 23 nëntorit 1983; dhe *Slivenko dhe të tjerët kundër Letonisë*, paragrafi 121, Aktgjykimi i GJEDNJ-së, i 9 tetorit 2003).
40. Parashtruesi i kërkesës mund të pretendojë shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1 dhe nenit 46 të Kushtetutës, vetëm për atë sa vendimet e kontestuara kanë të bëjnë me “pronën” e tij. Brenda kuptimit të kësaj dispozite “pronë” mund të jetë “pasuri ekzistuese”, duke përfshirë edhe pretendimet, në bazë të të cilave parashtruesit e kërkesës mund të pretendojnë “pritshmëri legjitime” që do të fitojnë gëzimin efektiv të ndonjë të drejte të pronësore.
41. Në pajtim me praktikën e GJEDNJ-së, nuk mund të thuhet se lind ndonjë “pritje legjitime” atje ku ekziston një kontest në lidhje me interpretimin e drejtë dhe aplikimin e së drejtës së brendshme dhe atje ku parashtruesit e kërkesës janë hedhur poshtë më pas nga gjykatat kombëtare (shih: *Kopecký kundër Sllovakisë*, paragrafi 50 i Aktgjykimit të GJEDNJ-së të 28 shtatorit 2004).
42. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi *prima facie*, dhe as nuk i ka mbështetur pretendimet se si dhe pse Gjykata Supreme i ka shkelur atij të drejtën në pronë, e cila është e garantuar me këtë dispozitë.
43. Si përmbledhje, Gjykata konsideron se kërkesa e parashtruesit nuk dëshmon se procedurat pranë Gjykatës Supreme kanë shkaktuar shkelje të të drejtave të tij të garantuara me nenet 31 dhe 46 të Kushtetutës, nenin 6 dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, si dhe nenin 10 të DUDNJ-së.
44. Prandaj, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme në pajtim me rregullin 39 paragrafi (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 20 të Ligjit dhe të rregullave 39 (2) dhe 59 (b) të Rregullores së punës, më 8 tetor 2019, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Bekim Sejdiu

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi